



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 2276/Prot.
2

Pogradec, më 20.05.2024

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Z. MANJOLA KAMOLLI

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:

" Për heqjen nga kontabiliteti, dhe lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, të vendstrehimit 8, që i korespondon pronës me numur 68 "Vëndstrehim" me vendodhje në Lagjen nr 3 Pogradec, i cili me VKM nr 1240 datë 10.09.2008 ka kaluar në pronësi të Bashkisë Pogradec"

Me respekt,

KRYETARI
Hir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1 (Një)

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2 (Dy)

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 14(Katërmbëdhjetë)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____.____.2024

PROJEKT-VENDIM
Nr. ____, DATË ____/____/2024

PËR

Heqjen nga kontabiliteti, dhe lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, të vendstrehimit 8, që i korespondojnë pronës me numër 68 "Vëndstrehim" me vendodhje në Lagjen nr 3 Pogradec, i cili me VKM nr 1240 datë 10.09.2008 ka kaluar në pronësi të Bashkisë Pogradec.

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr.1240, datë 10.09.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Pogradec, të Qarkut të Korçës", VKM nr 280 datë 15.01.1996 "Për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe dhenien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtëse" të ndryshuar, shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes nr 2205/2 date 19/04/2024 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë heqjen nga inventari ekonomik i Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike të vendstrehimit nr 8 që i korespondojnë pronës me nr 68 me emërtimin "Vëndstrehim" me vendodhje në Lagja nr 3 Pogradec, mbi pasurine 2/203, 2/178, 2/116 Zona kadastrale 8582 sipërfaqja 283 m2, që me VKM nr 1240 date 10.09.2008 ka kaluar në Pronësi të Bashkisë Pogradec.
2. Ngarkohet Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike, Sektori i verifikimit titujve të pronësive dhe shpronësimeve, dhe sektori Aseteve pranë Drejtorisë së Financave që në zbatim të ligjit nr 10296/2010 "Per menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Udhëzimin nr 30 datë 27.12.2011 "Per menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën", të Ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", të kryejnë veprimet në librat e inventarit ekonomik, përditesimin e listës së pronave të paluajtshme dhe fshirjen në regjistrat e pasurive të paluajtshme pranë Angjesisë Shtetërore të Kadastres Drejtoria Vendore Pogradec, të vendstrehimit nr 8 që i perket pronës me nr 68 me emërtimin "Vëndstrehim" me vendodhje në lagjen nr 3 Pogradec.
3. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETAR
MANJOLA KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT, DHE ADMINISTRIMIT TOKËS BUJQËSORE NË
NJËSITË ADMINISTRATIVE, TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE
SEKTORI TRAJTIMIT TITUVJE TE PRONËSISË DHE SHPRONËSIMEVE

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____ .2024

RELACION

PËR

Heqjen nga kontabiliteti dhe lista perfundimtare të pronave të paluajtshme, të "Vendstrehimit" nr 8, me nr 68 ne listen e inventarit, vendodhje ne Lagjen nr 3 Pogradec, i cili me VKM nr 1240 datë 10.09.2008 ka kaluar ne pronesi te Bashkise Pogradec.

I NDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARË !

Bashkia Pogradec në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave te paluajtshme publike te shtetit në njësitë e qeverisjes vendore ", të ndryshuar, Vendimit të Keshillit te Ministrave Nr.1240, datë 10.09.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Pogradec, të Qarkut të Korçës", VKM nr 280 datë 15.01.1996 "Për ruajtjen, mirembajtjen dhe dhenien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtëse" të ndryshuar, shkrese se Ministrise se Mbrojtjes nr 2204/2 prot date 17/04/2024, po ju paraqesim kete projektvendim i cili ka per qellim sistemimin ne kontabilitet, si dhe fshirjen nga lista perfundimtare te pronave te paluajtshme qe me VKM nr 1240 date 10.09.2008 ka kaluar ne Pronesi te Bashkise Pogradec, te prones me nr 68 te listes me emertimin "Vendstrehimi nr 8" me vendodhje ne lagjen nr 3 Pogradec, me vendodhje ne pasurine 2/203, 2/178, 2/116 Zona kadastrale 8582 me siperfaqe 283 m2.

Admistrata e Bashkise per pergatitjen e ketij materiali eshte inicuar nga nje kerkese e disa banoreve te lagjes nr 3 te cilet i jane drejtuar me kerkese Bashkise Pogradec mbasi Vendstrehimi ka dale jashte funksionit dhe eshte tejet i demtuar dhe amortizuar.

Bashkia ngriti grupin e punes dhe duke u bazuar ne VKM nr 280 datë 15.01.1996 "Për ruajtjen, mirembajtjen dhe dhenien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtëse" të ndryshuar, ju drejtua me shkresn nr 392/1 date 30.01.2024 Ministrise se Mbrojtjes ku ka kerkuar miratimin per nxjerrjen jashte perdorimit te ketij vendstrehimi.

Ministria e Mbrojtjes me shkresen nr 2205/2 date 19/04/2024 ka miratuar kerkesen tone per nxjerrjen jashte perdorimit te objektit "Vendstrehim nr 8" me nr 68 sipas VKM nr 1240 date 10.09.2008 me vendodhje ne Lagjen nr 3 Pogradec, prone mbi pasurine 2/203, 2/178, 2/116 me siperfaqe 283 m2.

Te nderuar Këshillatër,

Miratimi i ketij projektvendimi zgjidh keto probleme:



-Sistemon Kontabilitetin e Ndermarrjes se Mirembajtjes se Infrastruktura dhe Puneve Publike, per diferencen e krijuar nga nxjerrja jashte perdorimit te Objektivit "vendstrehim".
-Fshirjen nga lista perfundimtare te pronave te palusjteshme te prones me nr 68 te listes me emrtimin "Vendstrehimi nr 8" me vendodhje lagjia nr 3 Pogradec, qe me VKM nr 1240 date 10.09.2008 ka kaluar ne pronesi te Bashkise Pogradec.

Bashkangjitur relacionit aktet e meposhteme:

- VKM nr 1240 date 10.09.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtëshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Pogradec, të Qarkut të Korçës".
- Kerkesa nr 392/1 prot e dates 30/01/2024 derguar ministrise Mbrojtjes .
- Procesverbali i specialisteve te sektorit perkates per gjendjen e vendstrehimit.
- Pergjigjja e Ministrise se Mbrojtjes.
- Planvendosja e Prones.

Duke pasur besim te plote, ju ftojme te miratoni projekt vendimin e paraqitur.

Ju Faleminderit !

Konceptoi: Herolind MANELLARI

Spartak KUQO

Konfirmoi: Nexhmi TORRA

Miratoi: Ditan BABASULI

KRYETAR
ILIR XHAKOLLI

392/2
23.04.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
ZËVENDËSMINISTRI



FAKUM
SA
Urdhërshkruar
DMT
23.04.2024

Nr. 2205/prot.

Tiranë, më 19. 4. 2024

Lënda: Kthim përgjigje shkresës nr. 392/1 prot., datë 30.01.2024.

BASHKISË POGRADEC

Adresa: Bulevardi "Reshit Çollaku", Lagjja nr. 2, Pogradec

Pogradec

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 392/1 prot., datë 30.01.2024, me anë të së cilës dërgoni kërkesën për miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimit të objektit vendstrehim nr. 8, që ndodhet në listën e inventarit të bashkisë me nr. 68, i cili shtrihet në pasuritë nr. 2/203, 2/178 dhe 2/116, sipas VKM nr. 1240, datë 10.09.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Pogradec, të Qarkut të Korçës", shprehemi se:

Nga verifikimi në vënd nga strukturat e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së u konstatua se objekti vendstrehim nr. 8, që ndodhet në listën e inventarit të bashkisë me nr. 68, i cili shtrihet në pasuritë nr. 2/203, 2/178 dhe 2/116 vol.16, fq.25, ZK 8582, bashkia Pogradec, ka pjesë të shembura dhe bllokuara dhe është jashtë funksioni për të cilën është ndërtuar.

Për sa më sipër, Ministria e Mbrojtjes miraton vijimin e procedurave nga bashkia Pogradec për heqjen e objektit vendstrehim nr. 8, që ndodhet në listën e inventarit të bashkisë me nr. 68, i cili shtrihet në pasuritë nr. 2/203, 2/178 dhe 2/116 vol.16, fq.25, ZK 8582, bashkia Pogradec, në zbatim të planit zhvillimor të zonës sipas planit urbanistik.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT DHE ADMINISTRIMIT TOKES BUJQESORE NE NJESITE ADMINISTRATIVE
SEKTORI TRAJTIMIT TITUJVE PRONESISE DHE SHPRONESIMEVE

Nr. 392 Prot.

Pogradec, më 30.01.2024

Lënda / Kërkesë për miratim.

Z. NIKO PELESHI

MINISTRI MBROJTJES

TIRANË

Në bazë të ligjit nr 139/2015 datë 17/12/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" VKM nr 280 datë 15.01.1996 "Për ruajtjen, mirembajtjen dhe dhenien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtëse" të ndryshuar, dhe kërkesës së disa banoreve të lagjes nr 3 kërkojmë nga ana juaj:

Miratimin për nxjerrjen jashtë përdorimit të vendstrehimit nr 08 që ndodhet në listen e Inventarit të Bashkisë me nr 68, i cili shtrihet në pasurite 2/203,2/178 dhe 2/116, sipas VKM nr 1240 datë 10.09.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtëshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Pogradec, të Qarkut të Korçës", duke qënë se ky vendstrehim sipas aktit verifikimit bashkangjitur është shumë i dëmtuar dhe jashtë funksionit.

Bashkia Pogradec do t'ju vëjë në dispozicion çdo dokumentacion dhe informacion që ju do t'ju nevojitet për këtë proces.

Bashkangjitur korespondenca.

1- Akt Verifikimi.

2- VKM nr 1240 me fletën e inventarit përkatës.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KRYETAR
ILIR XHAKOLLI

ME URDHËR DHE ME DELEGIM
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
DRITAN BABASILI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E EMERJENCAVE, STREHIMIT DHE ADMINISTRIMIT TOKES BUJQESORE NE NJESITE ADMINISTRATIVE
SEKTORI TRAJTIMIT TITUJVE PRONESISE DHE SHPRONESIMEVE

AKT-VERIFIKIMI

“ Mbi gjendjen ekzistuese te objektit vendstrehim ndodhur ne Lagjen nr 3, rruga Nositi
prane shkolles 9-vjecare Gjok Shqiptari”

Vendstrehimi : Nr. 8

Inventar : Nr. 68

Nr. Pasurise : 2 / 203 , 2/116, 2/178

Siperfaqe Gjithsej : 283 m2 Siperfaqe e objektit : 283 m2

Nga verifikimi ne vend i objektit vendstrehimi Nr. 8 ju paraqesim kete foto dhe
shpjegues.



Vendodhja : Ky vendstrehim ndodhet prane shkolles 9-vjecare Gjok Shqiptari.

Gjendja Fizike : Ky vendstrehim eshte jashte funksionit pjeserisht dhe pothuaj jashte
funksionit si vendstrehim dhe ka demtime shume te medha, duke humbur funksionin qe
eshte ndertuar duket vetem nje hyrje dhe Brenda eshte i shembur dhe bllokuar.

Specialistet

Ing. Spartak Kuqo

Ekon. Herolind Malellari

Pergjegjesi i Sektorit

Nexhmi Torra

PLAN RILEVIMI



PERGATITI:
ark. Fillareta BUZO

Objekt:
Numer Inventar: Vendsirehim Nr.8,
66
ZK. 8582 NR. I PASURISE 2/203,116,278 Vol.16 Fq25.vol_fq

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISE
ILIR XHAKOLLI

Data:
1 / 2023

INDEKSI I HARTES:

SHKALLA: 1 : 500

Vula/Firma

ADRESA E PASURISE: RRETHI POGRADEC
Q/F: POGRADEC Rr/L
P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____

BASHKIA POGRADEC
PRONARI/ET (emri, mbiemri, firma/)



SIPERFAQJA TOTALE E PASURISE = 283 M2
SIPERFAQJA E NDERTIMIT = 283 M2

Legjenda:
Kufi parcele



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 1240 , datë 10.9.2008

P Ë R

MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN,
NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË POGRADEÇ, TË
QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Pogradec, të qarkut të Korçës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 65 (gjashtëdhjetë e pesë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 297 (dyqind e nëntëdhjetë e shtatë).



2. Ngarkohen ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Pogradecit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

SALI BERISHA

MINISTRI I BRENDSHËM

BUJAR NISHANI

Bashkia Pogradec

Lidhje 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
106,107	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
4-5,7-12,16	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor.	Në pronësi
158-170	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
173 (vetëm ambientet e shërbimit parësor), 175	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shërbimi parësor.	Në pronësi
1-3,6,13-15,17	Prona që përdoren në fushën e sportit kulturës	Në pronësi
19-90,	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtjen civile.	Në pronësi
91-105,110,113,	Infrastruktura (rrugë vendore,lulishte)dhe shërbime publike.	Në pronësi
115-116,	Varrezat publike.	Në pronësi
111	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
18	Prona që përdoren në fushën sociale	Në pronësi
114	Rrjeti i ndriçimit publik.	Në pronësi
112	Transferohen vetëm ledhe mezhda, shkëmbore, gurishtore,toka te pafrytshme.	Në pronësi
121-125,127,138-143,149,151,	Zyra te partive politike shoqatave ose zyra te tjera qe ndodhen ne ndertesen e bashkise.	Në pronësi
Z.Kadastrale 8582, pasurite nr.1/174,1/176,1/177,1/178,	Truall	Nuk transferohen

MINISTRI

Bujar NISHANI



Nr.prot.3748/1
DATË 17.9.2008




PRESIDENCËS
MINISTRISË SË BRENDSHME
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS
MINISTRISË SË MBROJTJES
MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT
MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS, RINISË
DHE SPORTEVE
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË
KËSHILLIT TË QARKUT TË KORÇËS
BASHKISË SË POGRADECIT
AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT
TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
ZYRËS QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

Gjergj LËZHJA
Sekretar i Përgjithshëm

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
 (Per inventarizimin e pronave te vecanta)

2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
		Vendstrehim	Vendstrehim Nr. 6 Tek banesa Nr. 142 Bashkia Pogradec	162		Mbrojtje civile	Bashkia	Bashkia	
		Vendstrehim	Vendstrehim Nr. 7 Tek banesa Nr. 110 Bashkia Pogradec	82		Mbrojtje civile	Bashkia	Bashkia	
		Vendstrehim	Vendstrehim Nr. 8 Tek banesa Nr. 113 Bashkia Pogradec	162		Mbrojtje civile	Bashkia	Bashkia	
		Vendstrehim	Vendstrehim Nr. 9 Prane stadiumit Bashkia Pogradec	76		Mbrojtje civile	Bashkia	Bashkia	
		Vendstrehim	Vendstrehim Nr. 10 Tek banesa Nr. 111 Bashkia Pogradec	82		Mbrojtje civile	Bashkia	Bashkia	
		Vendstrehim	Vendstrehim Nr. 13 Tek banesa Nr. 154 Bashkia Pogradec	128		Mbrojtje civile	Bashkia	Bashkia	
		Vendstrehim	Vendstrehim Nr. 14 Tek banesa Nr. 115 Bashkia Pogradec	116		Mbrojtje civile	Bashkia	Bashkia	



392

23.9.2024



REPUBLIKA E SHQIPERISE

“ONA” Sh.p.k.Pogradec

Pogradec, me 22 janar 2024

Nr. 1 Prot.

Lenda : Kerkese per heqje nga inventari vendstrehimi I popullates Nr.8

KRYETARIT TE BASHKISE POGRADEC

Z.ILIR XHAKOLLI

Kemi ndertuar nje objekt me adrese Lagja nr 3 ,Shkolla Gjok...
Shqiptari,rruga Nositi ,Pogradec dhe na eshte legalizuar me date 20.05.2017.

Ky ndertim ndodhet mbi pronen e quajtur Vendsrehim ,pasi ne momentin e ndertimit ai ishte jashte funksionit dhe i demtuar plotesisht,sidomos ne pjesen qe ze ndertimi i shoqerise tone “ONA”. Duhet te theksojme se ne momentin e ndertimit te objektit, nuk e dinim qe kjo pjese e vendstrehimit qe ishte e demtuar dhe jashte funksionit, duhej te hiqej nga inventari i pronave te

~~Bashkise~~

Ky objekt ndodhet ne Nr pasurise 2/203, vendstrehimi nr.8, inventari nr.68 ,siperfaqe gjithsej 369.m2 dhe siperfaqja qe ze ndertimi ,98 m2 .

Me kopetencat qe ju jep ligji nr.8744 date 22.02.2001,“Per transferimin e pronave te paluajtshme te shtetit ne njesite e qevisjes vendore”,i ndryshuar,te ligjit nr.111/2018,“Per Kadastren”, te ligjit nr.20/2020” Per miratimin e listes perfundimtare ,te pronave te paluajtshme publike,shteterore,qe transferohen ne pronesi ose ne perdorim te Bashkise Pogradec, ju kerkojme qe :

- Te hiqet nga inventari i pronave te Bashkise dhe te lihet shesh i lire , objekti i quajtur vendstrehim, pasi eshte bere pengese per rregjistrimin dhe




vazhdimin e procedurave ligjore, per tu paisur banoret me certifikata pronesia. Nga kjo perfitojne dhe jane ne pritje 65 familje qe kane 65 apartamente dhe 20 ambiente sherbimi.

Shpresojme ne mirekuptimin tuaj, me respekt

ADMINISTRATORE
(Alma DYRMISHI)

Alma Dyrmishi





PLAN RILEVIMI

PERGATITI: ark Fillareta BUZO	Olyektiv Vendstrehim Nr.8, Numer inventar . 68	MIRATOHET KRYETARI I BASHKISE ILIR XHAKOLLI
	ZK. 8582 NR. I PASURISE 2/203,116,278 Vol.16 Fq25.vol_fq	
Data: / /2023	INDEKSI I HARTES:	
	SHKALLA: 1 : 500	
	ADRESA E PASURISE: RRETHI POGRADEC Q/F: POGRADEC Rr/L P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____	
	BASHKIA POGRADEC PRONARI/ET (emri, mbiemri, firma/t)	



SIPERFAQJA TOTALE E PASURISE = 283 M2	Legjenda Kufi parcele
SIPERFAQJA E NDERTIMIT = 283 M2	